

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

DATE/A:	30.12.2025
PËR/ZA/ TO:	Salvador Elmazi – Drejtor i Departamentit të Buxhetit
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Ruzhdi Shehu - Kryetar i Komunës Junik
NGA/OD/FROM:	Ardita Hoxha, Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për dorëzim të dokumentacionit për planifikimin buxhetor 2026-2028 Për Komunën e Junikut.

I nderuar z. Drejtor

Kuvendi Komunal i Komunës së Junikut, në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me 11.12.2025, aprovon Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026/2028. Pas aprovimit nga Kuvendi Komunal dhe kompletimit të dokumentacionit sipas standardeve të kërkuara nga MFT, kërkojmë nga Institucioni i lartpërmendur që të bëjë të mundshëm pranimin e dokumentacionit të Komunës së Junikut. Përmbajtja e buxhetit total të Komunës së Junikut është me sa vijon:


1. Staf i për vitin 2026, është **199 punëtorë**.
2. Kategoria Paga dhe mëditje për vitin 2026, është : **1,898,712.00 €**
3. Kategoria Mallra dhe shërbime për vitin 2026, është **313,500.00€**
4. Kategoria e Shpenzimeve komunale për vitin 2026, është **54,900.00 €**
5. Kategoria e Subvencioneve për vitin 2026, është **70,000.00 €**
6. Kategoria e Shpenzimeve kapitale për vitin 2026, është **201,500.00€**

Totali i Buxhetit të aprovuar për vitin 2026, është 2,538,612.00 €

Dokumentet që i bashkëngjiten kërkesës janë:

1. Korniza Afatmesme Buxhetore 2026/2028
2. Vendimin për aprovimin e KAB-it, nga Kuvendi Komunal
3. Tabelat e Projekt Propozimit të Buxhetit Komunal për vitet 2026/2028
 - Tabela 4.1 nga sistemi BDMS
 - Tabela 4.2 për projektet kapitale nga sistemi PIP
 - Tabela 4.3 për të hyrat vetanake nga sistemi BDMS
 - Tabela e buxhetimit të përgjithshëm gjinor
 - Tabela e indikatorëve të performancës.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës

Nr. 02/28/25

Datë: 11.12.2025

Në bazë të nenit 61 paragrafi 2 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Ligji Nr. 03/L-048); nenit 40 paragrafi 2 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 21 paragrafi 21.1 pika e) të Statutit të Komunës së Junikut dhe nenit 19 paragrafi 15 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, Kuvendi i Komunës së Junikut në mbledhjen e tij të jashtëzakonshme të mbajtur me 11.12.2025 nxjerrë:

V E N D I M

për miratimin e Buxhetit të Komunës së Junikut për vitin 2026

I. Me këtë vendim miratohet Buxheti i Komunës së Junikut për vitin 2026 i propozuar nga Kryetari i Komunës së Junikut, dhe Korniza Afatmesme Buxhetore 2026-2028.

II. Buxheti i përgjithshëm i Komunës së Junikut për vitin 2026 është: **2,538,612.00 €** dhe është i shpërndarë në linjat buxhetore si në vijim:

1. Staf i për vitin 2026, është **199 punëtorë**.
2. Kategoria Paga dhe mëditje për vitin 2026, është : **1,898,712.00 €**
3. Kategoria Mallra dhe shërbime për vitin 2026, është **313,500.00€**
4. Kategoria e Shpenzimeve komunale për vitin 2026, është **54,900.00 €**
5. Kategoria e Subvencioneve për vitin 2026, është **70,000.00 €**
6. Kategoria e Shpenzimeve kapitale për vitin 2026, është **201,500.00€**

Totali i Buxhetit të aprovuar për vitin 2026, është 2,538,612.00 €

III. Komuna e ka bërë planifikimin duke respektuar kufijtë e Qarkores buxhetore 2026/02 për Komuna.

IV. Për zbatimin e këtij vendimi respektivisht ekzekutimin e buxhetit të Komunës së Junikut për vitin 2026 sipas linjave buxhetore nga pika II e këtij vendimi është përgjegjës Kryetari i Komunës së Junikut.

V. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohen vendimet tjera me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

VI. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Ministria e Financave;
3. Zyra e Kryetarit;
4. Shërbimi i kuvendit të komunës;
5. Arkivi i Komunës.

Kuvendi i Komunës së Junikut
z. Shpejtim Gacaferi

Kryesues

